



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 23.3.2023

Nr: 197

Ora: 18:24

VENDIM
PËR

**NDALIMIN E ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË ME KARAKTER PUBLIK TË MINISTRISË SË
SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**

Sot më datë 23.3.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

SUBJEKT: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

OBJEKTI: Ndalim i zhvillimit të veprimtarisë me karakter publik, të raportuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

BAZA LIGJORE: Neni 19, pikat 1, shkronja "n" dhe 2, neni 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator, "Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve",

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Në datë 23.3.2023, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve veprimtarinë publike me objekt "Inspektim në Spitalin Qendror në QSUT-Organizim i punës së urgjencës", për t'u zhvilluar në datë 27.3.2023 ora 10:00, me vend të zhvillimit në "Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" .

Data: 23.3.2023 Nr: 197
Ora: 18:24



"Për ndalimin e zhvillimit të veprimtarisë me karakter publik të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale"

Referuar nenit 92, pikat 1 dhe 2 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, parashikohet se institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

Përbëjnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë e hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin e publikut, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Raportimi në ndërfaqe duhet të kryhet jo më vonë se pesë ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë ose aktivitetit publik.

Qëllimi i raportimeve të veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike qendrore e vendore, agjencie, enteve dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, është marrja e masave, monitorimi dhe parandalimi i veprimtarive të ndaluara, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të institucioneve qendrore dhe vendore si dhe të administratës shtetërore.

Mosraportimi në kohë i veprimtarisë kufizon mundësinë e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të vlerësuar nëse përbën veprimtari të ndaluar ose jo.

Për sa më sipër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nga të dhënat e paraqitura në raportim ka konstatuar se, aktiviteti i raportuar nga institucioni publik, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, është raportuar jashtë afatit ligjor, në kuptim të nenit 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” dhe 2, nenin 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencie dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”,

VENDOS:

1. Ndalimin e zhvillimit të veprimtarisë publike me datë 27 mars 2023 me temë “*Inspektim në Spitalin Qendror në QSUT - Organizim i punës së urgjencës*” dhe vend të zhvillimit “*Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”*”.

Data: 23.3.2023 Nr: 197
Ora: 18:24



“Për ndalimin e zhvillimit të veprimtarisë me karakter publik të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”

2. Vendosjen e shënimit “*Ndaluar nga KQZ*” në ndërfaqen e raportimit.
3. Njoftimin e Autoritetit të Mediave Audiovizive të mos lejojë transmetimin apo pasqyrimin në rubrikat e lajmeve apo ato që mbulojnë fushatën në radio dhe televizione.
4. Ky vendim i njoftohet palëve nëpërmjet postës elektronike.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Illirjan CELIBASHI